



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2824/ 6 prot.

Datë 30.10.2025

V E N D I M

Nr. 1562/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AMEL-E.Z” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: Operatori ekonomik “AMEL-E.Z” SHPK me NIPT L71421032N dhe adresë: Lagjja Mezez, rruga Sokrat Miho , zona e Astirit, godine 9 - kateshe, ap 6/6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë)

Subjekte të interesuara: Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me adresë: NIPT M11313029O dhe me adresë: Rr. “Ndre Mjeda”

Kompleksi rezidencial “Magnet” Pallati Lura, njesi sherbimi nr. 1017, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.09.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”,

Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 29.09.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 03.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “AMEL-E.Z” SHPK	2,099,260	lekë	skualifikuar
- “Bajro Bros” SHPK	2,116,110	lekë	kualifikuar
- “Malbertex” SHPK	2,231,300	lekë	skualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar për arsye si vijon: *“Operatori ekonomik s`kualifikohet për arsye se: - Nuk plotëson pikën 2.1.b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi në SPE i formularit të sigurimit të ofertës paraqitur nga OE “AMEL - E. Z” sh.p.k. me NUIS L71421032N konstatohet se ky sigurim oferte nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor (OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA) sh.a. i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit.”*

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik më datë 09.10.2025, rezulton se është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 13.10.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5930 dhe me nr. 2824 prot., datë 13.10.2025 e operatorit ekonomik “AMEL - E. Z” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AMEL - E. Z” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2824/1 prot., datë 14.10.2025.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

II.8. Me datë 21.10.2025 përmes shkresës me nr. 2813/7 prot., datë 21.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2824/2 prot., datë 21.10.2025 është ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimi i KSHA nr. 116/2025 datë 20.10.2025 mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës duke argumentuar si vijon:

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

ARSYETON:

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “AMEL – E. Z” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës së tij me arsyen se Formulari i sigurimit të ofertës paraqitur nga OE “AMEL – E. Z” shpk nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor, pasi ky është një gabim formal që nuk ndikon në vlefshmërinë financiare të ofertës, as në lidhjen e saj me procedurën, pasi OBP zhvillon procedurën për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, KSHA arsyeton se:

Në pikën 2.1.b të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit është përcaktuar se: *“Ofertuesi duhet të paraqesë: Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.”*

Në Nenin 2 “Qëllim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale....

Në Nenin 21, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, citohet shprehimisht: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Në Nenin 83, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon

mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton përmes Sistemit të Prokurimit Elektronik pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e refuzimit të operatorit ekonomik për nënshkrimin e kontratës, sipas shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese "oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim" dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr."

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30 parashikohet se:

"1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

4. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet: a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin; b) të paguajë shumën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit/entit kontraktor.

5. Autoriteti/enti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga: a) data kur ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës, për të gjithë ofertuesit, përveç ofertuesit/ve fitues; b) data kur është lidhur kontrata, për ofertuesin/ët fitues; c) data kur janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues, për të gjithë ofertuesit.

6. Autoriteti/enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës, në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese; c) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. Në rast se kontrata nuk nënshkruhet nga ofertuesi fitues për ndonjë situatë të forcës madhore, autoriteti kontraktor nuk mban sigurimin e ofertës.

7. Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas shkronjave "b" dhe "c", të pikës 6, të këtij neni²⁵, të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti kontraktor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.

8. Në rastin kur, është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese "oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim" dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr. Me të njëjtin rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim në rast se diferenca e ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj."

Ndërsa në Nenin 92, pika 3 të LPP-së përcaktohet: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e Nenit 38 të këtij ligji. ..."

Mbështetur në kuadrin ligjor të prokurimit publik, KSHA konstaton se referuar dispozitave ligjore ku përcaktohet sigurimi i ofertës, ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë eksplicite vlerën monetare të sigurimit të ofertës (2 % të vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit); formën e paraqitjes së saj (në formën e një depozite apo garancie lëshuar nga një bankë apo një shoqëri sigurimi e licensuar) si dhe rastet specifike kur Autoriteti Kontraktor legjitimohet të konfiskojë sigurimin e ofertës.

Në Dokumentet Standarte të Tenderit është implementuar i gjithë informacioni i nevojshëm administrativ mbi përgatitjen e ofertave dhe dokumenteve të tenderit, i cili u vihet në dispozicion të gjithë palëve të interesuara, nëpërmjet publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Konkretisht, në datën 18.09.2025 është publikuar në SPE, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, me nr. REF-61685-09-17-2025. Në Njoftimin e Kontratës, Seksioni 3, pika 3.1 të DST, është përcaktuar qartazi informacioni i nevojshëm mbi Sigurimin e ofertës si më poshtë vijon:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 44,000 (dyzet e katër mijë) lekë

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma, monedha)

Loti 2 _____ (shuma, monedha)

3.1.2 Autoriteti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit kontraktor

Nr.	Banka	Nr. llogarise
1	Credins	AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030

3.1.3 Autoriteti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare X
ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente X

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga Operatori ekonomik ankimues “AMEL – E. Z” shpk, konstatoi se referuar dokumentit “Formulari i sigurimit të ofertës” me Nr. Serial 254116164, vlera e sigurimit të ofertës është siguruar në emër dhe për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, çka bie në kundërshtim me Dokumentet Standarte të Tenderit, Njoftimin e Kontratës, Seksionin III, pika 3.1.2, ku përcaktohet qartazi se sigurimi i ofertës duhet të bëhet në emër dhe për llogari të Autoritetit Kontraktor që zhvillon procedurën e prokurimit, konkretisht Operatori i Blerjeve të Përqendruara sha.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se Operatori i Blerjeve të Përqendruara është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror e krijuar me VKM Nr. 531, datë 07.09.2023 “Për krijimin e shoqërisë

aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe institucioneve të varësisë." (i ndryshuar).

Në pikën 5 të VKM-së Nr. 531, datë 07.09.2023 (e ndryshuar) citohet se: *"OBP" sh.a., është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimeve për mallra, punë, shërbime, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me vendim të Këshillit të Ministrave është përcaktuar ndryshe."*

Në lidhje me procedurën e prokurimit, theksojmë se Drejtoria e Përgjithshme Detare me vullnetin e saj të lirë i ka deleguar OBP sh.a të drejtën për të prokuruar kontratën e mallrave me objekt: *"Blerje uniforme, veshmbathje dhe element përbërës të tyre"* për Drejtorinë e Përgjithshme Detare" në përputhje dhe në harmoni me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi. Pra si rrjedhojë në kuptim të ligjit OBP sh.a është Autoriteti i vetëm Kontraktor, për zhvillimin e procedurës së prokurimit objekt i këtij ankimi.

KSHA gjykon se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor janë të detyrueshme për t'u përbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, KSHA gjykon, se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin konkret Formulari i sigurimit të ofertës, i paraqitur nga Ankimuesi bie në kundërshtim me Dokumentet e Tenderit, Njoftimin e Kontratës, Seksionin III, pika 3.1, ku përcaktohet qartazi se siguri i ofertës duhet të bëhet në emër dhe për llogari të Autoritetit Kontraktor që zhvillon procedurën e prokurimit, konkretisht Operatori i Blerjeve të Përqendruara sha.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik "AMEL – E. Z" shpk se "Sigurimi i ofertës nuk i është drejtur Operatorit të Blerjeve të Përqendrura sh.a, pasi ky është një gabim formal që nuk ndikon në vlefshmërinë financiare të ofertës, as në lidhjen e e saj me procedurën, pasi OBP zhvillon procedurën për llogari të Dr jtorisë së Përgjithshme Detare", Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, sigurimi i ofertës është një garanci ligjore nëpërmjet të cilës Autoriteti Kontraktor krijon sigurinë mbi qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e ofertave ekonomike të paraqitura për procedurën e prokurimit.

Ligjvënësi nëpërmjet Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 83; si dhe VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 30, ka parashikuar dokumentin e sigurimit të ofertës si një instrument ligjor që garanton se Operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk do të tërheqin ofertat pas afatit përfundimtar për paraqitjen e tyre si dhe nuk do të refuzojnë nënshkrimin e kontratës në rast të shpalljes fitues për procedurën e prokurimit.

Në Nenin 83, pika 2 të LPP-së citohet se: “2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”

Nga sa më lart konstatohet se legjislacioni i prokurimit publik i kushton një vëmendje të rëndësishme sigurimit të ofertës duke parashikuar rastet e paraqitjes së sigurimit të ofertës nga ofertuesit, vlerën si dhe formën e saj.

KSHA gjykon se sigurimi i ofertës në emër dhe për llogari të një institucioni të ndryshëm nga ai i Autoritetit Kontraktor, nuk mund të konsiderohet një gabim formal ashtu siç pretendon Ankimuesi, pasi Formulari i sigurimit të ofertës është një dokument, i cili ka fuqi ligjore dhe financiare për palët.

Nëse vlera e siguruar e ofertës do të bëhej në emër dhe për llogari të një institucioni të ndryshëm nga ai i Autoritetit Kontraktor, atëherë ky i fundit nuk do të mund të legjitimohej për të proceduar në dy momente të rëndësishme ligjore dhe konkretisht:

- Autoriteti Kontraktor nuk do të ketë tagër ligjor për të konfiskuar vlerën e siguruar të ofertës nëse do të jetë në rastet e parashikuara nga Neni 83, pika 3 të LPP-së;
- Autoriteti Kontraktor nuk do të ketë tagër ligjor për t'i kërkuar ofertuesit zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës ashtu siç parashikohet në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 24. Theksojmë se në këtë rast do të lindte një problem mbi mënyrën e trajtimit dhe shqyrtimit të ofertës gjatë procesit të vlerësimit të saj, pasi referuar po kësaj dispozite ligjore, ndër të tjera ligjvënësi ka parashikuar dhe të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të refuzuar një ofertë nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës për zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Ndodhur në kushtet ligjore si më sipër cituar, KSHA arsyeton se nëse Formulari i sigurimit të ofertës do t'i adresohet një institucioni të ndryshëm nga ai i Autoritetit Kontraktor, atëherë ky i fundit do të zhvishej nga çdo tagër ligjor në lidhje me sigurimin e ofertës. Pra në këtë mënyrë formulari në vetvete do ta humbiste qëllimin për të cilin ligjvënësi e ka parashikuar.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumentet e ofertimit duhet të jenë të sakta, të qarta dhe të mos lënë vend për interpretime apo nënkuptime, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të jetë në gjendje të verifikojë objektivisht përmbushjen e kërkesave të tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se nëse Operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit,

ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga Neni 110, pika 1 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”. Kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për Operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se Operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara parashikuar sipas pikës 1, Neni 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. [...]”.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi ekzistencën e dokumenteve si: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit; Formulari i sigurimit të ofertës; Xhiroja vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024); Çertifikata OEKO-TEX si dhe Deklarata e marrjes përsipër të prodhimit të veshjeve sipas specifikimeve teknike si dhe kryerjen e shërbimit të transportit, Komsioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Në Procesverbalin e Vlerësimit të mbajtur më datë 03.10.2025 nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si dhe në Formularin e Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit (publikuar në SPE më datë 04.10.2025), rezulton se Operatori ekonomik ankimues është s’kualifikuar për arsye se:

- Nuk plotëson pikën 2.1.b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi në SPE i formularit të sigurimit të ofertës paraqitur nga OE “AMEL – E. Z” sh.p.k. me NUIS L71421032N konstatohet se ky sigurim oferte nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor (OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA) sh.a. i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

KSHA konstaton se gjatë pasqyrit të procesit të vlerësimit të ofertave në SPE, një nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si rrjedhojë e një lapsusi, krahas arsyes reale dhe ekzistuese të s’kualifikimit të OE “AMEL – E. Z” shpk (Pra nuk plotëson pikën 2.1.b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi në SPE i formularit të sigurimit të ofertës paraqitur nga OE “AMEL – E. Z” sh.p.k. me NUIS L71421032N konstatohet se ky sigurim oferte nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor (OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA) sh.a. i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit), ka pasqyruar gabimisht dhe arsyet si më poshtë vijon:

- Nuk plotëson pikën 1, shkronjën a) dhe b), të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe sigurimin e ofertës.

- Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, pasi nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024).
- Nuk plotëson pikën 3 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik, pasi nuk ka paraqitur Çertifikatën OEKO-TEX (standarti 100, kategoria II) ose ekuivalente me to, të vlefshme të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstilë objekt prokurimi.
- Nuk plotëson pikën 4 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik, pasi nuk ka paraqitur deklaratën e marrjes përsipër të prodhimit të veshjeve sipas specifikimeve teknike si dhe kryerjen e shërbimit të transportit.

Në përfundim KSHA, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga Operatori ekonomik ankimes “AMEL – E. Z” shpk, ka konstatuar se dokumentet e pretenduara nga Ankimesi (konkretisht Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit; Formulari i sigurimit të ofertës; Xhiroja vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024); Çertifikata OEKO-TEX si dhe Deklarata e marrjes përsipër të prodhimit të veshjeve sipas specifikimeve teknike si dhe kryerjen e shërbimit të transportit) rezultojnë të ngarkuara në SPE nga Operatori ekonomik ankimes.

Për sa më sipër, pretendimet e Operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “AMEL – E. Z” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.9. Informacionin për shqyrtimin e ankesës, autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr. 2824/3 prot., datë 22.10.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “Amel-E.Z” SHPK bazuar në nenin 51 të Vendimit Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se: Komisioni zhvillon mbledhjen për shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a. juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b. legjitimitimin e ankuesit;

c. respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d. elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 48 të kësaj rregullorje.” KPP do të gjykojë fillimisht mbi legjitimitetin e ankimesit pasi vihet re se oferta ekonomike në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) është dorëzuar nga operatori ekonomik “Amel-E.Z” SHPK si dhe ankesa në sistemin e ankesave elektronike është paraqitur nga ky operator ekonomik por që është nënshkruar elektronikisht nga znj. E. B. Gjithashtu Komisioni vëren se bashkëngjitur ankesës ka një autorizim të datës 13.10.2025 të operatorit ekonomik “Amel-E.Z” SHPK që autorizon Znj. E.B me NID X që të paraqesë dhe nënshkruajë elektronikisht në emër dhe për llogari të shoqërisë “Amel-E.Z” SHP ankesën në platformën e-Albania, në seksionin:

“Ankesë nga Operatorët ekonomikë për Procedurë Prokurimi Publik” pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). Ky autorizim i jep znj. E. B të drejtën të përdorë nënshkrimin elektronik personal për firmosjen e dokumentit të ankesës dhe çdo dokumenti shoqërues, në përputhje me kërkesat e platformës e-Albania dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.”

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, i njohin të drejtën operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesë lidhur me vendimet apo veprimet e autoritetit kontraktor. Legjislacioni i prokurimit publik nuk parashikon ndonjë kufizim mbi mënyrën e përfaqësimit apo ndalimin e autorizimit të një pale të tretë që nuk është pjesë e tenderit, për sa kohë që operatori ekonomik që ka marrë pjesë në procedurë ka interes të drejtpërdrejtë si dhe përfaqësimi është i bazuar në autorizim të dokumentuar. Sipas përmbajtjes së autorizimit të sipërcituar operatori ekonomik “Amel-E.Z” SHPK ka shfaqur vullnetin që Znj. E.B të jetë përfaqësuesi i autorizuar i tij për procedurën e prokurimit objekt ankimi duke i dhënë edhe tagrin që të nënshkruajë elektronikisht në emër dhe për llogari të shoqërisë “Amel-E.Z” SHPK ankesën në platformën e-Albania, çka legjitimon ankesën e paraqitur në emër të operatorit ekonomik “Amel-E.Z” SHPK pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik por të nënshkruar elektronikisht nga përfaqësuesi i autorizuar Znj. E.B.

III.2. Gjithashtu, përpara shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “Amel-E.Z” SHPK, KPP gjen me vend të sqarojë pretendimet që do të marrë në shqyrtim referuar kjo tre dokumenteve provues: raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik; publikimit të njoftimit të fituesit në Buletinin nr.58 datë 13 Tetor 2025 të Agjencisë së Prokurimit Publik; formularit për publikim me nr. 2824/1 prot., datë 14.10.2025 të publikuar në faqen zyrtare të KPP-së. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se provuar se nga tre anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dy prej tyre

kanë vlerësuar “Operatori ekonomik s`kualifikohet për arsye se: - Nuk plotëson pikën 2.1.b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi në SPE i formularit të sigurimit të ofertës paraqitur nga OE “AMEL - E. Z” sh.p.k. me NUIS L71421032N konstatohet se ky sigurim oferte nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor (OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA) sh.a. i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit.” vlerësim i cili është pasqyruar edhe në publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin nr.58 datë 13 Tetor 2025 të APP, si dhe në formularin për Publikim me nr. 2824/1 prot., datë 14.10.2025 të publikuar në faqen zyrtare të KPP-së. Nga ana tjetër vetë KSHA në vendimin për shqyrtimin e ankesës ka pranuar se: “Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave si rrjedhojë e një lapsusi krahas arsyes reale dhe ekzistuese të skualifikimit të OE “Amel-E.Z” SHPK (Pra nuk plotëson pikën 2.1.b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi në SPE i formularit të sigurimit të ofertës paraqitur nga OE “AMEL - E. Z” sh.p.k. me NUIS L71421032N konstatohet se ky sigurim oferte nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor (OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA) sh.a. i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit) ka pasyruar gabimisht dhe arsyet si më poshtë vijon:

- Nuk plotëson pikën 1, shkronjën a) dhe b) të kriterëve të vecana të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe sigurimin e ofertës.
- Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe financiar, pasi nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitet financiare (2022,2023,2024.)
- Nuk plotëson pikën 3 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik, pasi nuk ka paraqitur Çertifikatën OEKO-TEX (standarti 100, kategoria II) ose ekuivalente me to, të vlefshme të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstile objekt prokurimi.
- Nuk plotëson pikën 4 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik pasi nuk ka paraqitur deklaratën e amrrjes përsipër të prodhimit të veshjeve sipas specifikimeve teknike si dhe kryerjen e shërbimit të transportit.”, vërtetuar kjo edhe përmes procesverbalit të vlerësimit të ofertave të KVO-së datë 03.10.2025. Ndodhur në këto kushte KPP gjykon se KSHA ka tejkaluar kompetencat e KVO duke marrë në shqyrtim pretendime të cilat sipas të gjitha rrethanave dhe fakteve nuk pasqyrojnë vlerësimin real të ofertave të kryer nga KVO dhe për këtë fakt KPP nuk do të marrë në shqyrtim këto pretendime. Objekt i shqyrtimit administrativ nga KPP do të jetë vetëm arsyeja e vërtetë e skualifikimit, referuar vendimmarrjes së dy prej anëtarëve të KVO që ka të bëjë pikërisht me formularin e sigurimit të ofertës, për të cilin KSHA ka vendosur mospranimin e saj.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “(Pra nuk plotëson pikën 2.1.b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi në SPE i formularit të sigurimit të ofertës paraqitur nga OE “AMEL - E. Z” sh.p.k. me NUIS L71421032N konstatohet se ky sigurim oferte nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor (OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA) sh.a. i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit)”, KPP vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.b të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

III.3.2. Në shtojcën 4 “*Formulari i Sigurimit të Ofertës*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.3.3. Në Seksionin 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*”, pika 3.1 “*Sigurimi i ofertës*”, dhe pika 3.2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes, afatin dhe vlerën e sigurimit të ofertës, si më poshtë:

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 44,000 (dyzet e katër mijë) lekë

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma, monedha)

Loti 2 _____ (shuma, monedha)

3.1.2 Autoriteti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit kontraktor

Nr.	Banka	Nr. llogarise
1	Credins	AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030

3.1.3 Autoriteti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare *X*
ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente *X*

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë)ditë

III.3.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin e Sigurimit të Ofertës me numër serie: 254116164 në emër të Amel-E.Z NIPT L71421032N, të lëshuar më datë 29.09.2025, nga shoqëria e sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” SHA për Drejtoria e Përgjithshme Detare, AL, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me përshkrim të shkurtër të Kontratës “Blerje uniforma,veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare” me REF-61685-09-17-2025, në të cilën deklarohet se janë garantues të Amel-E.Z NIPT L71421032N për një vlerë prej 44,000.00 lekë (dyzetë e katër mijë Lekë) si kusht për sigurimin e ofertës të dorëzuar nga ky operator ekonomik. Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 150 ditë nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

III.3.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.3.6. Në nenin 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”

III.3.7. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit²⁴. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.”

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.1.b të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura ka përcaktuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit, sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 të këtyre dokumenteve, si dhe sipas përcaktimeve në pikat 3.1.1, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar format alternative të paraqitjes së sigurimit të ofertës, në formën e garancisë bankare ose nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe vlerën e sigurimit prej 44,000.00 (dyzet e katër mijë) lekë, si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej 150 ditë që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

III.2.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” me numër serial: 254116164 të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Amel E-Z” SHPK, ai është lëshuar në njërën prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht nga shoqëri të licencuara nga autoritetet kompetente dhe përkatësisht shoqëria e sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” SHA, është sipas Shtojcës 3 të dokumenteve të tenderit të publikuara nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe ky formular është sipas vlerës së kërkuar nga autoriteti kontraktor në Seksioni 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*” të dokumenteve të tenderit. Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor KPP gjykon se ajo ka të bëjë me një “devijim të vogël” në ofertë në kuptim të asaj çfarë paragrafi i dyti i pikës 3 të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar konsideron si devijime të vogla të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit. Në këtë rast, duke qenë se referuar përmbajtjes së formularit të sigurimit të ofertës, numri i referencës së procedurës, objekti i prokurimit, vlera dhe periudha e sigurimit të ofertës përputhen me kërkesat e autoritetit kontraktor, drejtimi i formularit të sigurimit të ofertës një autoriteti tjetër kontraktor si Drejtoria e Përgjithshme Detare i cili në vetvete është përfitues i shërbimit nga blerja e përqëndruar e zhvilluar nga organi qendror blerës (autoriteti kontraktor) përbën një devijim të vogël në kuptim të asaj çfarë përcakton *lex specialis* mbi këtë rast. Ai nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nuk çënon përmbajtjen e ofertës si dhe nuk ka për qëllim të kthejë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se ankimuesi me dokumentacionin e dorëzuar e ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.b të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e

Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Amel-E.Z” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Amel –E.Z” SHPK, duke e kualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Amel-E.Z” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

